



Termt e Referencës

Konsulencë Nationale: Përpilimi i vlerësimit të nevojave për një model të integruar të shërbimeve të mbrojtjes dhe drejtësisë së fëmijëve për fëmijët në kontakt me ligjin në dy komunat e përzgjedhura.

Vendi i angazhimit: Prishtinë, me vizita të shpeshta në dy komunat e përzgjedhura, Pejë dhe Ferizaj.

Afati i aplikimit: 07 Dhjetor 2018

Kohëzgjatja e angazhimit: 14 ditë

Informata për projektin

Ky angazhim do të kontribuojë në qëllimin e përgjithshëm të sigurimit të qasjes së një numri me të madh të fëmijëve në drejtësi cilësore që nënkupton ofrimin e shërbimeve për fëmijëve në dy komuna, përmes demonstrimit të një modeli të shërbimeve të integruara për fëmijët në kontakt me ligjin, model i cili do t'i fuqizojë komunat për të ofruar shërbime duke i përdorur burimet të cilat ato i kanë në dispozicion. Në veçanti, ky angazhim nevojitet për ta bërë vlerësimin e nivelit të disponueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve përkatëse të ofruara nga institucionet komunale dhe akterë të tjerë relevantë që ofrojnë shërbime në fushën e drejtësisë dhe mbrojtjes së fëmijëve në komunën e Pejës dhe Ferizajt.

Ky aktivitet është pjesë e projektit **“Parandalimi i konfliktit dhe ngacmimit ndërmjet bashkëmoshatarëve në komunën e Gjilanit dhe Gjakovës dhe zgjerimi i ndërhyrjes në dy komuna të reja në Ferizaj dhe Pejë”** i cili financohet nga UNICEF dhe implementohet nga PEN, gjatë periudhës 2018 – 2019. Projekti ka për qëllim vetëdijësimin e mësimitdhënësve, prindërve dhe nxënësve mbi fenomenin e ngacmimit dhe konfliktit që ndodh ndërmjet bashkëmoshatarëve. Me anë të trajnimeve dhe ligjëratave, projekti do të kontribuojë në krijimin e një ambienti shkollor të sigurtë përmes informimit të prindërve, mësimitdhënësve dhe nxënësve për mënyrat efektive të komunikimit. Si rrjedhojë, do të mundësojë krijimin e mekanizmave parandalues të konfliktit dhe ngacmimit në shkollë.

Qëllimi i konsulencës

Qëllimi i konsulencës është përpilimi i dy raporteve të vlerësimit të nevojave në komunën e Ferizaj dhe Pejës, të cilat përmbajnë vlerësim të hollësishëm rreth gjendjes së fëmijëve në lidhje me drejtësinë për fëmijët. Ky vlerësim i gjendjes do të shërbejë për të identifikuar faktorët e rrezikut dhe mbrojtjes, që mund të përcaktojnë probabilitetin e fëmijëve që bien në kontakt apo konflikt me ligjin në komunat e përzgjedhura.





Vlerësimi duhet të përcaktojë qasjen më të mirë për fuqizimin dhe ofrimin e shërbimeve të integruara parandaluese, mbrojtëse dhe riintegruese si dhe përmirësimin e qasjes në shërbimet e drejtësisë dhe mbrojtjes së fëmijëve në nivel lokal. Gjithashtu, vlerësimi duhet të identifikojë sistemin komunal, institucionet dhe akterët që kanë ndikim direkt apo indirekt në rezultatet përfundimtare për fëmijët në fushën e drejtësisë dhe mbrojtjes së fëmijëve.

Duke u bazuar në të gjeturat dhe rekomandimet e dala nga vlerësimi, konsulenti nacional duhet të koordinojë hartimin dhe finalizimin e Planit të Veprimit për komunat përkatëse me qëllim të përmirësimit të gjendjes së fëmijëve në kontakt dhe konflikt me ligjin. Plani i Veprimit duhet të demonstrojë një model të shërbimeve të qëndrueshme, të integruara, parandaluese dhe reaguese për fëmijët. Në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja në zhvillimin e Planit të Veprimit, do të nevojiten mbledhje, takime, koordinime dhe këshilla me ofruesit e shërbimeve, mekanizmat ekzistues komunal dhe të komunitetit. Plani i Veprimit lokal do të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë dhe me kontribute të drejtpërdrejta të Shërbimit Sprovues, Qendrës për Punë Sociale, Drejtorisë së Arsimit, Policisë së Kosovës, institucioneve të tjera relevante dhe OJQ-ve lokale për mbrojtjen e fëmijëve në nivel komunal. Këta akterë do të identifikojnë qasjet/strategjitë dhe aktivitetet më të përshtatshme për parandalimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, si dhe fëmijëve në rrezik.

Metodologjia dhe qasja që do të përdoren:

Metodologjia do të bazohet në pjesëmarrjen dhe mbrojtjen e fëmijëve, duke shqyrtuar çështjet nga perspektiva gjinore dhe e barazisë. Vlerësimi mund të bëhet me shqyrtim dhe analiza të literaturës, tryeza të rrumbullakëta, punëtori, vizita në terren, fokus grupe dhe intervista me akterë të informuar, përfshirë fëmijët. Në fokus do të ketë cilësinë e shërbimeve ekzistuese të parandalimit, mbrojtjes dhe riintegrit, të cilat u ofrohen fëmijëve në kontakt me ligjin nga institucionet përkatëse si: Qendra për Punë Sociale, Policia, Drejtoritë komunale (shëndetësia, mirëqenia sociale dhe arsimit), Qendra Sprovuese e Kosovës, shkollat, strehimoret për viktime, zyrat për ndihmë juridike dhe shoqëria civile apo OJQ-të.

Detyrat e konsulentit dhe rezultatet e pritura

- Shqyrtim dhe analizë të shkrimeve apo materialeve duke përfshirë rishikimin e politikave përkatëse të mbrojtjes së fëmijëve, rregulloreve, udhëzimeve administrative, strategjive komunale, planeve të veprimit dhe dokumenteve tjera relevante.



- Vizita në terren, përfshirë diskutime në fokus grupe dhe intervista me akterë relevant të nivelit qendror dhe lokal, autoritete komunale, shoqërinë civile, fëmijë, familje dhe komunitete në komunat e përzgjedhura.
- Ta ndajë draftin e Planit të Veprimit të të dy komunave për shqyrtim dhe komente nga PEN, UNICEF, partnerë dhe akterë tjerë relevant nga komunat përkatëse dhe niveli qendror.
- Mbajtjen e punëtorive me akterët relevant për finalizimin e Planit të Veprimit.
- Finalizimin e Planit të Veprimit duke përfshirë inputet/komentet e PEN, UNICEF, autoriteteve lokale dhe akterëve tjerë relevant.
- Raport përfundimtar të Vlerësimit me gjetjet kryesore dhe Plan të qartë të Veprimit për secilën komunë përkatëse, me afate të qarta të implementimit të tij, me veprime dhe modele të qarta të shërbimeve për fuqizimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në nivel lokal, si dhe zhvillimin e shërbimeve të integruara parandaluese dhe reaguese për fëmijët.

Aftësitë dhe përvojat e kërkuara

- Nivel Master në Psikologji apo Punë Sociale, Sociologji, Juridik, shkenca sociale ose fusha të tjera relevante;
- Minimum 4 vjet ekspertizë profesionale në vlerësimin e programit/projektit, vlerësimin e ndikimit/zhvillimit të programeve/strategjive;
- Përvojë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe drejtësisë;
- Përvojë të gjerë në punën me fëmijët në konflikt me ligjin/fëmijët me sjellje anti-sociale;
- Përvojë të gjerë në kryerjen e vlerësimeve të ngjashme;
- Aftësi të shkëlqyera analitike me gojë dhe me shkrim, të komunikimit dhe raportimit në gjuhën shqipe dhe angleze.

Procedura e aplikimit

Dokumentet në vijim duhet të dorëzohen në e-mail adresën apliko@ngo-pen.com deri më datën **07.12.2018** ora **16:00**, duke e specifikuar në email: **Aplikim për Konsulencë – Përpilimi i vlerësimit të nevojave për një model të integruar të shërbimeve të mbrojtjes dhe drejtësisë së fëmijëve për fëmijët në kontakt me ligjin në dy komunat e përzgjedhura.**

- CV që përmban informatat mbi përvojat e kaluara dhe prapavijën profesionale e akademike, që vërtetojnë përshtatshmërinë tuaj për pozitën e ofruar;
- Raporte relevante të publikuara më parë;

Aplikimi është i hapur për individ, dhe vetëm personat e përzgjedhura në listën e ngushtë do të kontaktohen për intervistë.

